

AKT THEMELIMI
I Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar
"FUTURE - CONSTRUCTION"

Në këtë Akt-Themelimi:

- "Ligji" është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare";
- "Statuti" është Statuti i shoqërisë;

Në bazë të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" dhe Ligjit Nr.9273 datë 03.07.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" i ndryshuar:

Sot, më datë 04.02.2025 ne themeluesit kemi krijuar, Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar me emrin "FUTURE - CONSTRUCTION", Themeluesit e shoqërisë janë shtetasit:

1. Zj. Ulkina Gjokë DABAJ e datëlindjes 29.05.1974, lindur në Klos, Mat, dhe banues në, Rruga Oslo, Nd.446, H.1, Ap.1, Durrës 2003, shtetase shqiptare e identifikuar me numër personal (ID) H45529177K.

2. Z. Molos Gjokë DABAJ i datëlindjes 04.08.1979, lindur në Klos, Mat, dhe banues në, Rruga Oslo, Nd.446, H.1, Ap.1, Durrës 2003, shtetas shqiptar i identifikuar me numër personal (ID) H90804056F.

Shoqëri e cila do të funksionojë në bazë të këtij, **AKT-THEMELIMI**.

LLOJI DHE EMRI SHOQËRISË

NENI 1

Lloji i Shoqërisë Tregtare është Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar dhe emri i saj është "FUTURE - CONSTRUCTION". Emri tregtar i kësaj Shoqërie është "FUTURE - CONSTRUCTION".

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

NENI 2

Objekt i Shoqërisë Tregtare "FUTURE - CONSTRUCTION" është:

Sherbime konsulence, hartim i planeve kombetare, sektoriale vendore si dhe plane te detajuara vendore. Hartim i projekteve arkitektonike, konstruktive, hidrosanitare, HVAC, elektrike dhe te mbrojtjes ndaj zjarrit. Projektim ne fushen e infrastruktures. Hartim i raporteve per vleresimin e ndikimit ne mjedis. Hartim e raporteve ne lidhje me efencen energjitike. Supervizim, kolaudim. Projektim, zbatim, ne fushen e ndertimeve civile, turistike, bujqesore, ekonomike, veshje

fasadash, banesa, hotele, objekte kulti, rruge, infrastrukture, rikonstruksione civile, mirembajtje. zhvillim dekorit ne mjedise urbane. Prodhim, perpunim i materialeve te ndertimit, transportimi dhe tregtim i tyre. Magazinimi dhe shperndarja e materialeve te ndertimit. Organizimi dhe pajisja e panireve dhe ekspozitave te sherbimeve, reklamave dhe marketingu. Import dhe eksport i materialeve te ndertimit. Tregtim i tyre me shumice dhe pakice. Te zhvilloje edo veprimtari dhe aktivitet tjeter ne perputhje me legjislacionin shqiptar. Sherbime imobiliare.

Ulkinja Dabaja

Molos Dabaja

KOHËZGJATJA

NENI 3

Shoqëria Tregtare "FUTURE - CONSTRUCTION", do të kryej veprimtarinë dhe aktivitetin e saj për një periudhë kohore të papërcaktuar.
Ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkakui.

SELIA E SHOQËRISË

NENI 4

Zyra Qëndrore e Shoqërisë Tregtare "FUTURE - CONSTRUCTION", e ka vendodhjen e saj në, Rruga Skenderbej/4Shkalla:0, ndodhur ne ZK 8514, Nr. Pasurie 4/209-N14, vol. 20 fq 217 me sipërfaqe totale 56.20 (pesëdhjetë e gjashtë pike njezet) m2, Durrës.

REGJIMI JURIDIK

NENI 5

Shoqëria është shqiptare me përgjegjësi të kufizuar.
Shoqëria "FUTURE - CONSTRUCTION" fiton personalitetin juridik në momentin që ajo regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

KAPITALI I SHOQËRISË

NENI 6

Kapitali Themeltar i regjistruar i Shoqërisë Tregtare "FUTURE - CONSTRUCTION", përbëhet prej 100,000.00 (Një qind mijë) lekë.
Pjesmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e:

1. Zj. Ulkina Gjokë DABAJ: Zotëruese 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme që përbën 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë e barabartë me 50,000.00 (pesëdhjetë mijë) lekë.
2. Z. Molos Gjokë DABAJ: Zotëruese 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme që përbën 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë e barabartë me 50,000.00 (pesëdhjetë mijë) lekë.

ADMINISTRIMI

NENI 7

Administrator i Shoqërisë i emëruar është Z. Ulkina Gjokë DABAJ me një afat 5 vjet me të drejtë rizgjedhje.

Ulkina Gjokë Dabaj

Molos Dabaj
16.05.2022

TË DREJTAT E SHOQËRISË

NENI 8

Shoqëria ka të drejtë të lidh kontrata dhe të nënshkruaj marrëveshje Brenda dhe jashtë vendit. Shoqëria përgjigjet ndaj të tretëve vetëm dhe ekskluzivisht me kapitalin e derdhur. Shoqëria përballon humbjet vetëm dhe deri në kufirin e vlerës së kontributit të Kapitalit Themeltar.

VITI FINANCIAR-EKSPERTËT

NENI 9

Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe përfundon me 31 Dhjetor.

SHPËRNDARJA E FITIMIT

NENI 10

Fitimi që do të shpërndahet përbëhet nga fitimi i vitit financiar të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për rezervën sipas ligjit dhe nga ana tjetër janë zbritur ose janë shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e mëparshme. Ky fitim shpërndahet midis Ortakëve të Shoqërisë sipas kontributit të kuotave në kapitalin themeltar të shoqërisë.

LIKUJDIMI

NENI 11

Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilën parashikojnë mënyrën e likujdimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likujdatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likujdatorit dhe emërtesën shtesë "shoqëri në likujdim e sipër". Likujdimi kryhet nga likujduesit e emëruar nga Ortakët.

Aktin e themelimit e lexuam dhe e gjetëm konform vullnetit tonë dhe e nënshkruajmë pa verejtje.

ORTAKËT

E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "FUTURE - CONSTRUCTION"

Ulkina DABAJ



Molos DABAJ

